




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot. Br Prot. Prot No.
DPC	03-02/856/18
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	19.03.2018
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.03.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2458/17, për zyrtarin e lartë z. Bislim Zyrapi, Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokoli AKK-03-02-2458/17, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Bislim Zyrapi, Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Bislim Zyrapi, figuron si person i autorizuar në biznesin privat me emër “Active – Pharma” sh.p.k, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.



Pas kësaj shkrese z.Bislim Zyrapi, duke shfrytëzuar të drejtën për tu informuar lidhur me iniciimin e procedurës ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interesim për një takim për tu njoftuar për rastin që është duke u trajtuar.

Lidhur me këtë çështje sipas procedurës së paraparë, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë z. Bislim Zyrapi, në këtë takim zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me rastin e iniciuar.

Zyrtari i lart z. Bislim Zyrapi, është pajtuar me gjendjen faktike, por është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar lidhur me obligimet që rrjedhin nga ligji PKI, por ka deklaruar se aji ka mbet vetëm i regjistruar si person i autorizuar në këtë biznes e në realitet nuk e ushtron këtë detyrë, por ka deklaruar se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke hequr dorë nga funksioni si person i autorizuar i këtij biznesi, dhe pasi ti ndërmarr këto veprime do ta njoftoj Agjencinë.

Pas takimit informues me z.Bislim Zyrapi, dhe pas veprimeve të ndërmarra nga aji, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Bislim Zyrapi, Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk figuron me si person i autorizuar në bizneset privat me emër "Active-Pharma".

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z.Bislim Zyrapi, Këshilltar Politik i Presidentit të Republikës së Kosovës, duke bërë ndryshimet në biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në biznesin privat janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

